Komuna e Klinës
Kuvendi i Komunës
01Nr. 06- 3471 */2026*
Klinë, 03. 11 */2026*

PROCESVERBAL

Nga Seanca e VIII-të e rregullt e Kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur me datë 25 shtator 2026 në orën 10:00, në sallën e mbledhjëve të kuvendit.

Pjesmarrës: Kryetari i Komunës, z. Zenun Elezaj, nënkryetari, z. Fadil Gashi, drejtorë të drejtorive, përfaqësues të OSBE, përfaqësues nga Instituti GAP, mediat lokale dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi kryesuesi i kuvendit, z. Enver Berisha

z. Enver Berisha, kryesues: Përshëndetje, mirë se keni ardhur në seancën e rregullët të asamblesë komunale në Klinë. Unë para se të hyjnë në agjendë të rendit të ditës, paraprakisht ashtu siç po veprojnë edhe në komunë e tjera dhe në gjithë Kosovën, që nga data 16 shtator, Kosova po përballet me një shqetësim jashtëzakonisht madh, me një vendim që është nxjerrë nga Gjykata e Hagës për ish krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që padrejtësisht po mbahet aty. Duke bazuar që ai vendim është i padrejtë dhe është i papranueshëm, për faktin se edhe ekspertë më të madhenjë të çështjeve juridike po e vlerësojnë se është i padrejtë dhe është politik dhe ne me të drejtë të plotë, edhe si kuvend, edhe si klinë, nuk e njohim këtë vendim. Bashkarisht gjithë po mundohemi që ta çojmë reflektimin e pakënaqësisë të popullit të Kosovës që gjykata në rastin e apelit të nxjerr vendim të drejtë, të nxjerr vendim lirues, sepse Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk ka qenë as organizatë terroriste, nuk ka pasur as ndërmarrje të përbashkët kriminale, por ka qenë thjesht një ushtri që ka luftuar për lirinë e këtij vendi dhe ajo si e tillë do të jetë gjithmonë. Para jush kemi ofruar një deklaratë që e shpreh pakënaqësinë tonë për atë padrejtësi që është bërë atje. Kështu që para se të hyjmë në agjendë unë ju kisha lutur që këtë deklaratë të cilën besoj e keni marrë të gjithë, që është bërë pothuajse edhe në komuna të tjera, sepse është i njëjti qëllim, i njëjti e njëjta pakënaqësi që po shfaqet kudo, kisha kërkuar që fillimisht ta aprovojmë, dhe mandej të vazhdojmë

me pika të rendit të ditës. A po pajtoheni që kjo deklaratë të kalojë në aprovim apo ka dikush diçka për të thëë rrethe kësaj? Nëse jeni dakord, atëherë kush është për aprovimin e kësaj dekrate në këtë kuvend të komunës?

Me vota unanime të anëtarëve të kuvendit u MIRATUA.

Kryesuesi i kuvendit z. Enver Berisha vazhdoj fjalën

z. Enver Berisha, kryesues: Po ashtu para se të kalojmë në rendin e ditës, kam një nga përfaqësuesit e institucionit GAP, është Antigona Lucaj, e cila më është lutur që ta marrë fjalën për përshëndetje, sepse tash e tutje këta do të jenë një monitorim të kuvendit. Unë do t'ia kaloj fjalën zonjës Antigona.

Znj. Antigona Lucaj, ins. GAP: Faleminderit. I ndëruar kryetar, i ndëruar kryesues, të ndëruar drejtorë të drejtorive dhe të ndëruar asamblistë. Jam Antigona nga Instituti GAP, ju falënderoj për mundësinë që sot, para fillimit të kësaj seance, t'ju prezantoj shkurtimisht një aktivitet të rëndësishëm që lidhet drejtpërdrejt me punën tuaj në këtë komunë. Bëhet fjalë për projektin e monitorimit dhe performancës së asamblistëve dhe të financave komunale, i zbatuar nga një konsorcium prej katër organizatash, Instituti GAP, Instituti KGI, ATRC dhe CBM, në kuadër të projektit të LDK dhe AsdemOS i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, Zvicra dhe Suedia. Qëllimi i këtij projekti është i thjeshtë, të forcojmë transparencën dhe llogaridhënien në kuvendet komunale, duke dokumentuar dhe vlerësuar në mënyrë objektive angazhimin e anëtarëve të këtyre kuvendeve. Në fund të këtij procesi do të identifikohen dhe shpërblehen anëtarja apo anëtari më aktiv, si dhe anëtarja apo anëtari më aktive në mandatin e mëparshëm në nivel vendi, domethënë jo vetëm në komunën e Klinës. Monitorimi ka me u zhvilluar në 26 komuna të Kosovës dhe do të përfshijë periudhën nga korriku i këtij viti 2026, deri në fund të muajit mars të vitit 2027. Monitorimi do të përqendrohet në rolin e asambleistëve brenda kuvendit komunal, por edhe angazhimin e tyre për çështjet me interes publik jashtë kuvendit. Për këtë qëllim, konsorciumi i organizatave ka hartuar një metodologji të bazuar në indikatorë matës, përmes së cilës do të sigurojnë saktësi dhe paanshmëri në vlerësim. Performanca vlerësohet përmes nëntë indikatorëve të ndara në tri role kryesore, roli përfaqësues, ku përfshihen takime me qytetarët e Këshillit lokal, përfshirja e grupeve të margjinalizuara, si dhe adresimi i kërkesave të tyre në kuvend. Roli legjislativ, ku do të vlerësohet kontributi në hartimin e akteve rregulloreve dhe çështjeve financiare, si dhe roli mbikëqyrës, kërkimi i llogaridhënies nga ekzekutivi dhe monitorimi i projekteve komunale. Monitoruesit tanë do të ndjekin seancat e kuvendit, do të shqyrtojnë protokollet, incizimet dhe dokumentacionin zyrtar. Në komunën e Klinës, në emër të konsorciumi tonë do të jetë monitoruesja Florinda Gashi. Ky proces do të jetë i hapur dhe i induktuar mbi parimet e ndershmërisë, saktësisë, pa anshmërisë, si dhe dokumentimit dhe argumentimit të plotë të rezultateve. Prandaj ju vazhdoni të ushtronii rolin tuaj, të ngrini shqetësimet e qytetarëve, kontribuoni në seanca legjislative, kërkoni llogaridhënie nga ekzekutivi. Nëse organizoni takime me qytetarë, nëse vizitoni ndonjë fermë në terren, lutëm që t'i publikoni ato në Facebook, me fotografi ose shënime, sepse kjo është dëshmi që ndihmon t'ju vlerësojnë sa më drejt. Para jush i kemi vendosur broshurat dhe printurat, të cilat kanë më shumë detaje rreth procesit të vlerësimit. Ju falënderoj edhe një herë për kohën dhe për bashkëpunimin me ju dhe me kryesuesin gjatë gjithë kësaj kohe të këtij monitorimi. Faleminderit shumë.

z. Enver Berisha, kryesues: Faleminderit shumë, zonja Antigona! Atëherë e kalojmë te rendi i ditës, po besoj që materialin e rendit të ditës e keni marrë me kohë, edhe nuk e di a ka dikush që nuk i ka shkuar materiali ose ka ndonjë ankesë. Fillimisht, para se me aprovu këtë rend të dites, duhet me ju njoftuar se pika e pestë, ku bëhet fjalë për shqyrtimin dhe ndërtimin e planifikuar për objektin social, që është menduar te Qendra Sportive, ne sipas komunikimit që e kemi me ministrinë, na është kërkuar që të sot te shtyhet kjo pikë e Rendit të Ditës, për faktin se ende s'ka kaluar përmes hartave zonale, edhe po mendojmë që do të kemi mundësi të tjera që ndoshta deri në seancën e radhës, me e gjetur një mundësi shtesë. Kështu që po e heqim nga Rendi i Ditës për shkak të kësaj sepse po na kushton neve si kuvend realisht, po duhet me i tërheq vendimet tona, kështu që në këtë rast, rendi i ditës të aprovohet me heqjen e kësaj pike. A ka dikush diçka për rendin e ditës? Nëse jo, atëherë kush është për aprovimin e këtij rendi të ditës bashkë me tërheqjen e kësaj pike?

Të gjithë janë për, kundër s'ka, abstenim s'ka, APROVOHET rendi i ditës

Pika 1 e Rendit të Ditës: Arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi tha se deri tash ka katër njoftime për mungesat, është Azdren Ramadani, që është jashtë vendit, ka një shqetësim shëndetësor. Po ashtu, është Marigona Raci, po ashtu mungon edhe Rita Përnokaj, që ka shqetësime shëndetësor në familje.

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me 30/7/2026.

Të gjithë anëtarët janë për, kundër s'ka, abstenim s'ka, MIRATOHET

Kryesuesi Berisha Kërkoj falje që nuk e bëri të ditur prezencën e kryetari, nënkryetarit, drejtorëve, mediave etje.

Pika 3 e Rendit të Ditës: Rekomandimet e KPF-së

Kryesuesi i kuvendit tha se në komitet i kemi rekomanduar në adresa ku duhet të shqyrtohen dhe të japin përgjigje kërkesat dhe pyeti se a mund të votohen në pako këto rekomandime.

z. Esat Raci: Përshëndetje kryesues, përshëndetje për të gjithë. Jam që të votohen në paketë, mirëpo qysh e kam përmend edhe në seancën e komitetit për politikë dhe financa, në seancën e fundit që e kemi pasur, dua ta theksoi kërkesën e qytetarit Hysen Desku. Kërkoi që të shiqohet mundësia t'i ndihmohet asaj familj. Ne e njohim situaten e rëndë që e ka Desku.

z. Enver Berisha, kryesues: Kjo ka qenë edhe rekomandim i komitetit për politikë dhe financa, por besoj që kjo kërkesë do të trajtohet pak më seriozisht edhe në bazë të mundësive buxhetore që i ka kryetari i komunës të i ndihmohet.

Me vota unanime, asnjë kundër, asnjë abstenim U MIRATUAN.

Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të drejtorisë së arsimit për ndarjen e bursave për studentë dhe formimin e komisionit për ndarjen e bursave.

z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA: Faleminderit kryesues, përshëndetje të gjithëve. Drejtoria e arsimit, siç do vit dhe këtë vit, ka sjellë në kuvend për ndarjen e bursave për vitin akademik 2025/2026, dhe kërkesën për formimin e komisionit. Drejtoria e arsimit asamblesë i ka propozuar të ndanë 80 bursa në vlerë 50 euro për çdo muaj, në vit 600 euro. Prandaj kërkoj që kjo të aprovohet në mënyrë që studentët nga komuna e Klinës t'i gëzojnë këto bursa, faleminderit.

z. Esat Raci: Faleminderit kryesues. Unë kam një kërkesës për kryetarin dhe drejtorin për buxhet dhe financa, që brenda mundësive buxhetore t'ju shtohet shuma bursave edhe për 100 euro. Domethënë 700 euro në vit, duke e ditur inflacionin edhe standardin e jetës që është rritur për çdo ditë, kështu që kjo është kërkesë e imja, që realisht po i bjen nga 10 euro në muaj, jo më tepër.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje për kryetarin e komunës, profesor Dr. Zenun Elezi, përshëndetje për ju kryesues, drejtorët e të gjithë të pranishmit. Edhe unë jam që të shtohet shumë e bursave sepse ato para janë para minimale për studentin. Është mirë që të shihet që të hiqet një projekt apo asfaltimi i rruge, me u lanë diçka mangu edhe me ju dhënë studentëve një vlerë më të madhe.

z. Arben Limanaj: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Edhe ne si grup, jemi për propozimin e drejtorisë së arsimit për mbështetjen e studentëve. Edhe nëse ka mundësi edhe drejtoria e financave na jep një sinjal që është mundësia për rritjen e shumës prej 50 eurosh, atëherë jemi edhe ne pro kësaj rritje të ndihmës për studentë.

Z. Valmir Bacaj: Faleminderit kryesues. Unë besoj se s`ka asambleist që nuk dëshiron që të rritet shuma ose vlera e përvitshme e bursave. Por ne duhet t'i keni parasysh faktet se po përballen jo vetëm komuna e Klinës, por edhe të gjitha komunat e tjera me procedurat përmbarimore. Edhe çdo propozim duhet të ketë edhe një analizë financiare, besoj që drejtoria e arsimit e ka bërë këtë analiza financiare edhe ka ardhur në këtë përfundim se shuma është optimale. Unë e di se nuk është e mjaftueshme për një student, por më mirë është me marrë ndonjë vendim që është i zbatueshëm, se sa të rritet vlera, të bëjmë propozime e vendime dhe pastaj që mos të realizohet. Ne duhet të marrim një vendim të arsyeshëm edhe që mund të realizohet në bazë të buxhetit që ka drejtoria e arsimit. Kështu që ne pajtohemi me me propozimin e drejtorisë së arsimit.

Kryesyuesi tha se në parim po e votojmë këtë draft vendim në mbështetje për studentët, por nëse krijohen mundësitë buxhetore të mund të ndodhte edhe rritja.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë anëtarët e kuvendit, mediat, edhe gjithë që janë prezentë. Pajtohem me mendimin e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit që është jashtëzakonisht e vështirë me bë ndonjë zgjidhje për me u rrit vlera e burses. Po mundohem me ju treguar që asnjë cent nuk është duke u paguar nga subvencionet, se kjo është kategori e subvencioneve,edhe pagesat e lindjeve edhe shërbimet e varrimit janë kategori e subvencionëve. 60.000 euro prej investimeve kapitale kemi bërë propozim për me i kaluar në subvencione që me pas mundësi të I mbulojmë shpenzimet në këtë kategori. Fatkeqësisht, tani na ka ardhur dhe një pagesë përmbarimore prej 120.000 euro, domethënë 2.5 milionë veç kanë shkuar deri tash. 120.000 euro është një kërkesa për pagesë tani, nuk e di ku kanë me I marrë. Kështu që kjo është arsyeja e vetme se ne nuk mund ta bëjmë ndonjë zgjidhje për me u rrit vlera e bursave për studentët. Edhe viti i ardhshëm ka me qenë i vështirë. Unë e kam dërguar një shkresë konkrete në Qeveri, edhe kam qenë shumë modest, kam kërkuar 300.000 euro, për ndarje nga fonde emergjente që kanë, për

me mundur me i mbuluar pagesat e lindjeve, shërbimet e varrimëve, furnizimin e shkollave me gjëra higjiene, sepse edhe furnizimi i shkolla. Rryma në shkolla, lëndë djegëse në shkolla, janë tejet problematike. Këta katër muaj, domethënë tre muaj që i kemi deri në fund të vitit, vërtet kanë qenë të vështirë edhe ekzekutivi e ka jashtëzakonisht vështirë me e tejkaluar këtë problem. Unë po shpresoj që pas formimit të qeverisë, se kërkesën e kam dërguar diku para një jave tek Ministria e Financave dhe Kryeministri, do të mundohem që me lobu edhe me nxjerrë diçka. Përndryshe, jemi në një gjendje jo të mirë. Nuk po du shumë me i frikësuar qytetarët, por vërtet jemi kështu, jam i sinqertë. Faleminderit

z. Arben Limanaj: Deshiroi me pyt drejtorin e arsimit.Ky komision po formohet për vitin akademik 2023-2026. Dhe viti akademik tjetër fillon me 1 tetor. Domethënë, po bëhet fjalë për vitin akademik të ardhshëm që do i ndajnë bursat. Kështu që me 1 tetor fillon viti akademik tjetër. Tash, qysh është, mos është tash ndonjë gabim, apo e keni lënë që për këtë vit të jenë bursat?

z. Qemajl Sejdiu, drejtor I DKA: Nuk është asnjë gabim, në këtë kohë votohet komisioni zakonisht edhe është për vitin akademik 2025-2026, edhe nuk jemi me vonesë, por jemi me kohë.

z. Armend Beqiraj: Përshendetje. Një vit i bjen para për shkak që duhet deshmi për shkak notës mesatare.

Me 23 janë për, kundër s'ka, abstenim s'ka. MIRATOHET numri dhe shuma e bursave

Kryesuesi kaloj tek formimi i komisionit, ky komision formohet prej pesë vetëve, dy janë nga asambleja, dy janë nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile.

Nga Arben Limanaj u kerkua që dy anëtarët e komisionit të jenë nga opozita ndërsa Valmir Bacaj tha se duhet të shkojmë sipas praktikave të kaluara dhe rregullores.

U propozuan: Ekzekutivi: Astrit Muhaxheri, Nikson Dakaj. Nga Aleanca u propozura

Faton Berisha.Nga PDK u propozua, Naim Musliu.

Me 20 vota për, kundër s'ka, abstenim 3. MIRATOHET

Piika 5 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi i raportit të dëgjimit për draft buxhetin e vitit 2027,

z. Faruk Smaili, drjetor I FEZH: Të nderuar anëtarë të kuvendit. Pas nxjerrjes së qarkorës së dytë buxhetore, komuna e Klinës ka zhvilluar procesin e dëgjimeve buxhetore me qytetarët dhe grupet e interesit, për qëllim të prezantimit të kufijve buxhetorë dhe prioriteteve për vitin 2027. Grupi i punës për hartimin e draft buxhetit ka shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe propozimet e parashtruara nga qytetarët, duke i vlerësuar ato në bazat e prioriteteve, rëndësisë, ndikimit në komunitet dhe mundësitë buxhetore të komunës. Janë organizuar gjithsej 12 dëgjime buxhetore me qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit, në kuadër të këtyre dëgjimeve kanë marrë pjesë 147 qytetarë, prej të cilëve 17 gra dhe 130 burra. Gjatë procesit të dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin për vitin 2027, janë pranuar gjithsej 58 kërkesa dhe propozime, 39 kërkesa janë pranuar, 14 kërkesa janë adresuar dhe 5 kërkesa janë refuzuar për shkak të kufizimeve buxhetore, kritereve

të planifikimit ose pamundësisë së përfshirjes në këtë projekt buxhet. Pas, këtyre dëgjimeve komuna e Klinës ka mundësuar që kërkesat dhe prioritetet të jenë pjesë e procesit dhe finalizimit të projekt buxhetit për vitin 2027.

Pika e 6 e Rendi të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i draft-buxhetit për Komunën e Klinës për vitin 2027

z. Enver Berisha, kryesues: Kjo është pika më e rëndësishme për vitin kalendarik, për vetë faktin që aty prezantohen, hartohen, mendohen projektet, proceset, zhvillimet që komuna ka me i pasur në vitin vijues. Jam I vetdijshëm se gjitha mundësitë dhe debatet që i kemi pasë, ekzekutivi ka bërë vlerësimin e vet, ka vlerësuar ato propozime që janë të arsyeshme dhe të domosdoshme, ato edhe kanë gjetur vendin në këtë draft buxhet. Unë, edhe pse i vetëdijshëm se secili prej juve e din, por, po ndihem I obliguar me e thënë se kjo pikë është pika më e rëndësishme dhe mendoj që nuk kish qenë mirë me pas dallime në votime për shkak se, kudo që investohet në komunën e Klinës, investohet për të gjithë qytetarët, pa dallim partie, ose me thënë pak më ndryshe, kudo që investohen, preken votuesit e secilit subjekti politik.

Kryesuesi vazhdoj me fjalën e tij duke arsyetuar këtë project buxhet

Znj. Teuta Mulaj: Përshëndetje për gjithë së pari, Me qenë se përfaqësuesit e tjerë politik kanë qenë në Komisionin për Politikë dhe Financa, unë i kam adresuar këto kërkesa, po e pashë të arsyeshme që me i sjellë edhe me shkrim në këtë mbledhje. Bëjë pyetje, nëse kërkojmë mjete shtesë buxhetore, duke i ditur vështirësitë financiare në të cilën ndodhemi për shkak të përmbaruesit, për kontratat kolektive, a mendoni që këto planifikimet buxhetore, me të vërtetë do të do të jenë, do të implementohen gjatë vitit 2027.

z.Faruk Smajli.drejtor I FEZH: Sot pra, para jush po prezantojmë draft buxhetin e komunës së Klinës për vitin 2027. Pas pranimit të qarkores së dytë buxhetore e cila na e përcakton kufirin përfundimtar, prandaj të cilit komuna duhet të planifikojë buxhetin e saj. Gjatë përgatitjes së draft buxhetit janë shqyrtuar kërkesat e drejtorive komunale, kërkesat e qytetarëve, të paraqitura gjatë dëgjimeve buxhetore, si dhe projektet kapitale të cilat janë më të vlerësuara si prioritare për vitin 2027. Pra, për vitin 2027, buxheti i përgjithshëm i komunës së Klinës është 16.845.517 euro, ku pjesa më e madhe e këtij buxheti shkon për paga dhe mëditje me 10.182.134 euro, ndërsa për mallra dhe shërbime 1.600.000 euro, shpenzimet komunale 370.000 euro, subvencione dhe transferë 800.000 euro, investime kapitale 3.893.383 euro. Në krahasim me kufijtë e përcaktuar në kornizën e parë buxhetore, fondi për investime kapitale na është zvogëluar për 308.000 euro. Këto mjete janë orientuar në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, si rezultat i përcaktimit të kufijve buxhetorë në qarkoren e dytë buxhetore. Pra, kemi një kufizim hapësirë financiare për investime kapitale, për këtë arsye gjatë hartimit të draft buxhetit, jemi detyruar që projektet kapitale t'i renditim sipas prioriteteve dhe nevojave me urgjencë të komunës. Ne kemi punuar së bashku me qytetarët që të përcaktojmë secila projekte janë me urgjencë dhe të cilat duhet t'i kenë përparësi dhe mjete të disponueshme, i propozojmë që të miratohet ky draft buxhet për vitin 2027.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Edhe kryesuesi e potencoj që pjesa e parë nuk është problematikë. Ndërsa për sa i përket dy projekteve kapitale ne këtë projekt, këtë kërkesë, mendojmë me realizuar një bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe unë kam marrë premtime që, po kjo nuk

është vetëm për at rrugë, por është një projekt që do të jetë me një vlerë diku rreth 2 milionë euro me bashkëfinancim, dhe përfshin ë rrugën ë Jashanicë, Jellovc, Resnik, rrugën Gjurgjevik i madh, domethënë prej rrugës së Ujmirit deri në magistralen Pejë- Prishtinë, përfshin rrugën Kpuz – Qeskovë, Kpuz-Dollovë. Pastaj Rranoc, Leskoc edhe lidhet në rrugën tek ura e Haxhisë deri tek pompa Kastrati. Të gjitha këtë rrugë janë rrugë që planifikojmë me i ndërtuar, por që nuk mund me e bë me buxhetin tonë vetëm. Në qoftë se nuk do të kemi mbështetje nga niveli qendror. Unë e kam marrë një premtim paraprak, por që na duhet me punu, duhet me lobuar për me arritur, po shpresoj shumë që këtë vit me e filluar këtë project. Për sa i përket kërkesës që bëtë, është e vërtetë që ne me buxhetin komunal nuk mund t'i realizojmë këto projekte, në qoftë se nuk do kemi mbështetje. Edhe unë besoj shumë që këto rrugë do të bëhen do të shtrihet një shtresë e re për gjithë këto rrugë, duke dhënë një vlerë ndoshta dy milionë euro.

Z. Tunë Dedaj: Unë e kam një kërkesë për kryetarin e komunës, që në buxhet të paraparshihet asfaltimin i rrugës në Deiq, që shkon te Elshant. Edhe s'e kam kuptuar kurrë, me ato 300.000 euro

z. Zenun Elezaj, kryetar: Lagjja Elshani i ka rrugët derë më derë, domethënë asfalt. Po kërkesa e fundit është për një rrugë me një emër Valon Elshani, që është kërkesë e familjes për shkak të emrit, që ajo rrugë me u shtru. Atë rrugë do ta mirëmbajmë, ta pastrojmë prej meturina, edhe ta shtrojmë me zhavorr dhe në një moment të mundshëm, sigurisht që do ta kemi parasysh edhe kërkesën tuaj.

Znj. Mendehie Duraku: Faleminderit kryesues. Përshëndetje për kryetarin, drejtorët, kolegë asambleistë dhe të gjithë të pranishëm. Sa i përket draft buxhetit për vitin 2027-2029, në këtë draft buxhet kam parë që është projektuar projekti ndërtimi i nënkalimit në lagjen Dukagjini. Por për këtë projekt janë paraparë 0 euro në vitin 2027, 10.000 euro në vitin 2028 dhe 10.000 euro në vitin 2029. Duke pasur parasysh rrezikun që paraqet kjo rrugë për banorët dhe qytetarët që e frekuentojnë këtë rrugë, unë pyes drejtorin, a konsideroni se këto mjete janë të mjaftueshme për një projekt që kërkon ekspertizë, projektim dhe investim shumë të madh? A do të ketë komuna angazhim konkret që ky projekt të realizohet dhe jo vetëm të mbetet i paraparë në buxhet me këtë shumë simbolike?

z. Zenun Elezaj, kryetar: Për ndërtimin e nënkalimit është besoj se do të bëhet realitet, po mos planifikimit të buxhetit është bërë për shkak të pasigurisë, sepse duhet të funksionalizohet ura e cila kalon lumin afër fushës së futbollit, domethënë stadiumi i Dukagjinit, po kemi pasiguri për shkak të procesit të shpronësimit. Edhe këto ditë, kemi bërë një kërkesë re, është përgjithësi mbi bazën e memorandumit të mirëkuptimit që procesin e shpronsimit ta realizojë Ministria e Infrastrukturës. Por kemi disa çështje, për shembull ka shpronësime të viteve 80-ta, të cilat nuk janë implementuar në katastër. Edhe drejtoria që merret me shpronsim në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ka konstatuar diku 7 prona, të cilat e kanë shpronësimin e dyfishtë. Edhe neve na është bërë me dije që atë proces do ta marrim përsipër ne. Ose të bëjmë implementimin ose ekzekutimin e vendimeve të viteve të mëparshme. Mirëpo drejtoria e katastrit ka probleme sepse nuk i ka fletëpagesat. Domethënë, po ta kishin një fletëpagesë, ne do ta ekzekutonim pa problem. Në këtë kuptim, për shkak të pasigurisë në shpronësim, nuk kemi guxuar me planifikuar buxhet. Përndryshe, ekziston mundësia, ekziston mekanizmi që me mjete të bartura me i shtu mjetet edhe menjëherë me e kry këtë projekt. Domethënë, nuk ka me pas problem për shkak të

buxhetit. Në momentin që do të jemi të gatshëm ta funksionalizojmë urën, sepse derisa të drejtohet nënkalimi, domethënë është e pamundur që ajo lagje të lëvizë në drejtim të nënkalimit.

Z. Naim Musliu: Përshëndetje kryesues, kryetar, drejtorë, kolegë asambleistë, qytetarë të Klinës. Nëse shikojmë buxhetin kështu në përgjithësi, në krahasim me vitin 2026, buxheti ka një ngritje të përgjithshme diku prej 506.690 euro. E vetmja kategori që ka pësuar rënie të financimit është kategoritë për investime kapitale. Kjo është shqetësuese, Është shqetësuese gjithashtu edhe ulja e grantit për arsim, i cili ka përfshirë diku rreth 561.000 euro. Nuk e di, drejtori ndoshta mund të na bëjë sqarime, cilën kategori të shpenzimeve e atakon kjo ndalesa, ose ulja, kategorinë e pagave dhe meditjeve dhe shpenzimeve apo si është puna aty. Ky buxhet, nëse e krahasojmë me buxhetin e viteve të kaluara, në masën më të madhe, mbi 90% është një farë copy-paste i projekteve të vitit 2026. Edhe ato projekte i kemi parë vitin 2026, shumica dërmuse, ato projekte po i shohim edhe në vitin 2027. Kam disa shqetësime, kemi si grup. Gjatë buxhetit të vitit të tashëm, nuk është planifikuar asnjë cent për zgjedhjen e problemit për ujin e pijshëm, që është problemi numër një që e kanë qytetarët e komunës së Klinës. A u dorëzua komuna, apo keni ndonjë plan tjetër të bashkëfinancimit, sepse në buxhet, të paktën nuk figuron. Gjithashtu nuk keni planifikuar asnjë cent për shpenzimet kontigjente, të cilat komunës po i sjellin probleme financiare. Këto projekte që i keni planifikuar, a do të mund të realizohen, apo nuk do të mund të realizohen, janë vetëm projekte në letër. Shumica e këtyre projekteve po na sjellin këtu në Kuvend, po i miratojnë, po kalojnë vitet, s'po përfundojnë, po përsëriten, deri kur ka me vazhdu kjo trendi jo i mirë. Disa projekte janë planifikuar fonde për vitin 2027, nuk është planifikuar pastaj asnjë cent në vitin 2028, edhe është planifikuar prapë buxhet në vitin 2029. Që po e marrim vetëm një shembull. Për shembull, rruga Shaban Sadiku, është një rrugë në lagje këtu, 50 mij financim në vitin 2027, 0 cent në vitin 2028, dhe 50 mij në vitin 2029. Që ka keni planifikuar me këtë rrugë? A keni planifikuar me hek asfaltin, me lanë në zhavorr, qysh I keni lënë shunmë rrugë të tjera? Si është e mundur që rrugën Mal Bashota. Ju e keni larguar asfaltin që ka qenë, ekzistues. E keni shndërruar rrugën në rrugë zhavori, edhe e keni lënë ashtu për një periudhë, kohë të gjatë. Edhe banorët janë ballafaquar me këtë problem. Tash e di që janë duke u shpallur procedurat për rregullimt, por nuk e di kur ka me u kry kjo rrugë, edhe sa kohë kanë me u ballafaquar ata qytetarë me pluhurin e madh. Një projekt tjetër që e kemi diskutuar këtu edhe komuna e ka hequr pak përgjithësinë e vet, është padyshim rruga Sadik Rama, kjo rruga tash është rregulluar, qershorin e kaluar, por nëse i kqyrim cilësinë e atyre punimeve, unë besoj që ky dimri që po vjen, kur vjen panvera, prapë ka me pas ndërhyrje. Nuk di a ka komuna inspektor me i mbikqyrë. Në fund, tek kësaj, ju nuk ishin në gjendje me e mirëmbatjë sheshin e qytetit të Klinës, por zgjodhet rrugën më të lehtë, me i shit kubzat, kalldremin, dhe me shëndërruar në asfalt. A mundeni me na dhënë një çmim, se sa janë shitë kubzat? Ne në fund të diskutimit, kërkojmë pesë minuta, kohë shtesë, për me pas një konsultë, sepse si grup i kuvendarëve të PDk-së, kemi dilema të mëdha se si do të veprojmë , të votojmë apo jo.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Rreth konstatimit që investimet kapitale janë zvogëluar, procedura e hartimit të buxhetit është e tillë që vlerën e investimeve kapitale nuk e cakton komuna, por janë kufijtë buxhetorë që vijnë nga Ministria e Financave. Edhe kjo,vijnë kufijtë buxhetorë për kornizën afatmesme buxhetore në majë, deri më 15 maj, ndërsa në gusht, deri më 15 gusht vijnë kufijtë buxhetorë për vitin pasues, që në këtë rast është viti 2027 . Nuk jemi ne ata që vendosim, sepse janë parametrat ligjor me të cilët ndahet buxheti, edhe duke pasur parasysh faktin se popullata e komunës së Klinës ka rënë nga regjistrimi, atëherë është implementuar edhe kriteri i

numrit të banorëve dhe na ka goditur, i ka goditur të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, përjashtim një, dy, tri komunat që kanë rritje. Por që ne na është dashur, domethënë me i kompensuar këto. Rreth ujit të pije, ne këtë vit kemi diku në rreth 200.000 euro investime, këtë vit veç po firmoset kontrata, kemi planifikimin për vitin e ardhshëm nëpër fshatra, ndërsa tani jemi në procedurë, në përgatitjen e projektit. Sepse me thënë të vërtetën, dilemat e mia janë, dhe fokusimi im kryesor është që ne të kemi një projekt të realizueshëm. Edhe këto ditë po negociojmë me KFË, që për me pas një projekt, sepse unë po mendoj që projekti është mirë me u hartuar nga një institucion kredibil, mundësisht edhe pse jo me ekspertizë ndërkombëtare, dhe kur të investojë, sepse investimi nga komuna është i pafuqishëm me e kryer. Por unë po i them që vitin e ardhshëm ne duhet të mendojmë që ndoshta të ndalim çdo investim dhe të fokusohemi, të përqëndrojmë në realizimin e kësaj kërkese që është për finalizimin e zgjidhjes së çështjes së ujit të pije për komunën e Klinës. Për shpenzimet kontigjente, ne jemi të pasigurtë, domethënë nuk e dimë sa janë kërkesat e përmbaruesve, edhe nuk na japin informacionet. Rruga Shaban Sadiku është paraparë me u financuar me bashkëfinancim nga kodi i bashkëfinancimit, dhe nuk është e specifikuar, përndryshe rruga Shaban Sadiku është, në fazën e firmosjes së kontratës, kështu që është objekt kontraktual. Edhe rruga Mal Bashota është e firmosur kontrata, është buxheti i siguruar, problemi i kemi me shpronësimin. Edhe rruga Sadik Rama është komplet përgjegjësi e Ministrisë së Infrastrukturës.

Znj. Marqe Tanushi: Faleminderit kryesues. Përshëndetje për të gjithë. Ne pamë planifikimin buxhetor, pamë projekte, rrugë dhe shumëçka që i duhet komunës së Klinës pa dallim zonave. Në përgjithësi i kemi parë formën dhe mënyrën se si janë shpërndarë. Ajo që më intereson është edhe si rekomandim, sepse unë nuk e kam hasur dikund buxhetimin gjinor. Duke e ditur se buxhetimi gjinor nuk është që lypset ndonjë buxhet shtesë, mirëpo ai buxhet që është apo projekte që janë paraparë të shkojnë në dobi edhe të një kategorie tjetër që janë gratë dhe vajzat ose një kategori tjetër që është më e cenueshme. Nuk e kam vërejtur asnjë projekt konkret që së paku përmendet buxhetimi gjinor. Mos të flasim mandej për projekte të tjera që u fol shumë për ato rrugë të cilat kanë mbetur pa shtruar, të tjera të cilat nuk janë paraparë ende, por nuk mund të flasim për projekte të mëdha kur paraprakisht thuhet se s'ka buxhet.

z. Arben Limani: Qëndrimi ynë si grup kuvendar lidhur me buxhetin për vitin e ardhshëm edhe planifikimet për vitet e tjera, na si grup, edhe unë si shef i grupit, po thuj se këtë periudhë sa jam si asambleist, nuk e di ndonjëherë që një propozim i caktuar që ta ketë gjetë mbështetjen e ekzekutivit. Domethënë, njëfar neglizhence e ekzekutivit edhe njëfar mospërfillje, gjatë gjithë këtij rrugëtimi, edhe pse si grup kuvendar cdo herë kemi qenë konstruktiv, edhe nuk kemi qenë bllokues. Nuk janë përkrahur projektet të cilat dalin nga kërkesat e qytetarëve. Kjo mosmospërfillje na bën ne si grup që mos marrim pjesë gjatë votimit të buxhetit. Thjesht, mosmospërfillja është arsyeja që në këtë seancë nuk do të jemi pjesë e votimit të buxhetit.

z. Valmir Bacaj: Ne sot e kemi në rend dite pikën më të rëndësishme që është, votimi I buxhetit për vitin 2027. Sigurisht se hartimit të këtij buxheti I ka paraprijë një punë e palodhshme dhe përkushtim sidomos në aspektin e mbajtjeve të dëgjimeve publike. Fillimisht me kryetarët e bashkësive lokale, pastaj edhe me me lokalitete të ndryshme, që janë mbajtur gjatë kësaj kohe takime edhe është një punë e lodhshme.

Nga gjithë këto takime u thanë edhe në raport, që kanë qenë 58 kërkesa nga qytetarët, aty ku kemi mundur me marrë pjesë si grup kuvendoresh, si asambleistë, në lokalitetet e caktuara, kemi marrë pjesë, i kemi prezentuar kërkesat tona.

Është një lajm i mirë që prej gjithë kësaj 58 kërkesa, 90% e kërkesave janë marrë parasysh, janë kondensuar në detaje dhe raportin e dëgjimeve publike, edhe ato pesë kërkesat të cilat nuk kanë mundur me marrë përgjigje, domethënë, edhe janë refuzuar, janë refuzuar me bazë, sepse nuk ka pasur mundësi buxhetore. Ne e shohim një shpërndarje të drejt të buxhetit në lokalitete të caktuara. Tash qëndrimet e grupeve kuvendare janë ato që janë, është e drejt demokratike e tyre të kanë qëndrimin, pro apo kundër buxhetit, por është edhe një lloj përgjegjësia edhe ndaj qytetarëve, sepse nëse nuk merr pjesë në asnjë dëgjim publik, nëse nuk e bën asnjë propozim dhe nuk e jep asnjë kontribut, zero kontribut në hartimin e buxhetit, nuk e jep asnjë projekt bazuar me analizë financiare dhe jep vlerësim tash se nuk na kanë aprovuar kërkesat me zero kontribut në hartim e buxhetit dhe duke mos me e përfill asnjë procedurë, atëherë unë e shoh si papërgjegjësi totale ndaj qytetarëve.

Naimi e tha që nuk janë paraparë shpenzimet kontigjente, në asnjë buxhet nuk parashihen shpenzimet kontigjente, sepse nuk mundesh me ditë sa janë. Si grup kuvendar, ne jemi pro investimeve kapitale, pro realizimeve të projekteve, jemi pro ndarjes edhe pagesa të bursave, që sapo morëm vendim, sepse ato bursa janë në këtë buxhet që e votojmë.

Nuk është buxhet perfekt, se nuk ka buxhet perfekt, por në bazë të mundësive buxhetore është buxheti më I mirë i mundshëm.

z. Esat Raci: Sidoqoftë vendimi ynë si grup kuvendar është drejtë e jona që të kërkojë pesë minuta sic e tha Naimi, drejtë ekskluzive e jona. Është e vërtetë që procedurat kanë shkuar në rregull, është e drejta jonë prapë që jemi të votuar nga qytetarët, ta marrim pjesë ose mos të marrim pjesë. Po prej praktikave të mëparshme edhe kryesuesi që është, që ka qenë në radhët e PDK-së, kemi ardhur me dhjetë propozime të listuara por nga kryetari edhe nga ju si pushtet, asnjë s'ka hyjnë në listë. Kështu që, sidoqoftë të jetë vendimi jonë, ne për hir të qytetarëve, absolut jo për hir të pushtetit, nuk do ta bëjnë votim kundër apo abstenim. Do të na keni mbikqyrës.

Në vazhdim fjalën e mori përsëri z. Naim Musliu, shef I grupit kuvendar të PDK-së, I cili paraqiti serish vërejtjet e veta për draft buxhetin. Ndërsa z. Armend Beqiri në fjalën e tij ishte plotësisht dakord me draft buxhetin por theksoi se ne si anëtarë të kuvendit kemi përgjegjësi të dyfishta; Ta mbeshtesim punën në interes të qytetarëve dhe Të kërkojmë llogari dhënje për cdo cent që shpenzohet. Z. Beqiri tha se në parim e mbështetë këtë buxhet por duke sugjeruar që të merren parasysh të gjitha vërejtjet e anëtarëve kolegë të kuvendit. Gjithashtu z. Valmir Bacaj diskutoi duke replikuar ose përgjigjur në vërejtjet që paraqiti z. Raci dhe z. Musliu. Por kjo nuk ngeli pa repliken e z. Esat Racit. Znj. Teuta Mulaj përmendi shumë rrugë që është dashur të futen në planifikim dhe që nuk ajnë future prandaj si rrjedhoj do të mungoj vota e saj pro këtoij buxheti.

Kryetari I Komunës, z. Zenun Elezaj, tha se përvec kërkesave, dy, nga znj Mulaj asnjë kërkesë për ndonjë project nuk ka ardhur. Kryetari përmendi edhe Esat Racin ehd eArben Limanaj në kontekstin që asnjë herë nuk I kanë thënë që të përfshihet ndonjë kërkesë për ndonjë project prnadja

nuk mund të thonë se jam jo bashkpunues. Ai e përfundoi se cdo kërkesë që më vije nuk e shef as si Alenacë, as si PDK apo LDK etj por si kërkesë e qytetarëve.

z. Esat Raci replikoj duke ja përmendur vitin 2019 kur shefi I grupit kuvendar të PDK-së, z. Enver Berisha ka ardhur me shtatë projekte dhe asnjë nuk I keni marrë për bazë. Kësaj radhe është dashur që të thirren sheft e grupeve dhe të ju kërkohej që të I sjellnin project kërkesat. Por këtë nuk e keni bërë – tha, z. Raci

znj. Florentina Berisha: Pas shiqimit dhe analizës së buxhetit, pash që kategoia e cenueshme e përsonave me nevoja të vecanta nuk ishte përfshirë në buxhet. Kërkoj që kjo kategori të përfshihet në buxhet.

z. Valmir Bacaj kiundërshtoj atë që e tha z. Raci. Ai tha se të akuzohet kryetari se nuk është bashkpunues nuk qendron.

Debate rreth kësaj që u tha më lartë në mes të z. Esat Racit dhe Valmir Bacajt vazhdoi tutje. Po ashtu z. Armend Beqiri foli për dilemen që znj Teuta Mulaj ngriti për buxhetin e vogël për ngrohjen e qytetit.

Debatet vazhduan tutje derisa në një pikë kërkesës së grupit kuvendar të PDK për 5 minuta konsultime në mes të grupit ju dha mundësia.

Pas 5 minutave pushim, kryetari i grupit kuvendar të PDK-së, z. Naim Musliu u deklarua se do ta votojnë pro këtë buxhet për hir të qytetarëve të Klinës, ndërsa znj. Teuta Mulaj u deklarua që do të abstenoi, ndërsa grupi kuvendar I LDK-së nuk morri pjesë në votim.

Me 19 vota për, 1 abstenim (LVV) , asnjë kundër U MIRATUA

Pika 7 e Rendit të Ditës: Informatë për ofrimin e shërbimeve komunale ndaj mërgimtarëve gjatë sezonit veror

z. Binak Sylaj, drejtor i administratës: përshendetje për të gjithë. Ju e dini që gjatë kësaj periudhe sikurse edhe në të kaluaren, administrate komunale ka qenë e angazhuar dhe e përkushtuar që sa më mirë të presim mergimtarët tanë. Këtë vitë admoinistratta, zyrtarët e gjendjes civile ka qenë në krye të detyrës dhe nuk aknë munguar fjalët e mira të mergimtarëve. I falenderoi të gjithë sektorët komunal për angazhimin dhe sjelljen e tyre.

Pika 8 e Rendit të Ditës: Informatë rreth përgatitjeve të vitit shkollor 2026-2027

z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA: me 1 shtator ka filluar procesi mësimor, komuna e Klinës në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave e kemi filluar procesin në të gjitha shkollat. Kemi pasur sfida, duke filluar prej ministrisë së arsimit për subvencionimin e teksteve, ky problemi çdo vit po na përcjellë. Ne e kemi pranuar, është viti i parë që kemi pranuar prej ministrisë së arsimit një deklaratë formale ku na është kërkuar që çdo prindi me ja dërguar edhe ata me nënshkruar, me marrë përgjegjësinë që ato mjete që ndahen për tekste mësimore po përdoren për ata edhe për çka ndahen.

Pengesa tjetër që e kisha quajtur ka qenë edhe mungesa e ditarëve, për shkak që procesi ka ndryshuar, edhe ministria e arsimit e ka marrë një vendim tjetër ku një shtëpi tjetër botuese ka fituar të drejtën për të botuar ditarë dhe mos me pasë çmime të ndryshme, ka qenë një proces i mirë, unë mendoj që është i mirë, për shkak se i detyron të gjitha drejtoritë e arsimit që të kenë çmimet e njëjta për ditarë edhe për libra që kërkohen çdo fillim. Por procesi ka qenë i vonuar shumë, dikund në javë e procesit mësimor ka shkuar derisa komunat edhe komuna e Klinës është furnizuar me ditarë.

Këtë vit drejtoria e arsimit është hera e parë që nuk kemi mundur me investuar në shkolla ashtu siç duhet, se më të vërtetë kemi ndonjë shkolla që ka nevojë shumë në mënyrë që të rinovohet dhe kompletohet. Uroj që vitin që vjen mos me na gjetë ashtu, por t'i rregullojmë ato. Kemi edhe mungesa të mëdha dhe kërkesë të vazhdueshme për asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta, që është vërtetë sfidë edhe për ata prindër, edhe për atë kategori.

z. Naim Musliu: Dua t'i përshëndes të gjithë nxënësit dhe mësimdhënësit për fillimin e këtij viti shkollor, duke iu dëshiruar shëndet dhe suksese. Ky vit shkollor është ndoshta një nga vitet më të papërgatitura, që nga paslufta. Disa i përmendi drejtori. Ky vit shkollor ka filluar me neglizhencën e Ministrisë së Arsimit, por edhe pamunësinë e komunës për t'u përgatitur ashtu siç duhet. Kanë munguar tekstet shkollore për nxënësit në shumë raste, kanë munguar ditarët e klasave, që janë dokumentet kryesore, por kanë munguar edhe investimet e nevojshme në shkolla. Ka pasur plot pengesa, mangësi e të tjera. Në përgjithësi arsimi në komunën tonë po ballafaqohet me disa probleme, të cilat padyshim që do të lënë pasojë për të ardhmen. Ndërsa komuna, nuk ka, ose s'e paku, ne nuk jemi të njoftuar, se si do të çaset zgjidhjes së këtyre problemeve. Po i përmend disa nga problemet kryesore: Rënia e numrit të nxënësve nëpër shkolla të ndryshme. Mbingarkesa me mësimdhënës, përkatësisht mësimdhënësit tepricë, të cilët e ngarkojnë edhe buxhetin e komunës së Klinës. Centralizimi i arsimit në komunë, siguria në shkolla edhe disa probleme të tjera. Rënia e numrit të nxënësve në komunën tonë është goxha shqetësuese. Sipas studimit të Institutit GAP, Klina për 3 vitet e fundit ka gjithsej 659 nxënës më pak. Ka disa shkolla që kanë më pak se 50 nxënës. Ndërsa ka klasa me vetëm 2 apo 3 nxënës. A jeni të vetëdijshëm se këta nxënës nuk do ta marrin arsimin e duhur në kushtet e tilla?

Pyetje është se çfarë do të bëhet me këto klasa, këto shkolla, a ka komuna një plan, një strategji qasjeje? Komuna e Klinës ka gjithsej100, që janë tepricë e sistemit, në arsim, duke e llogaritur me numrin e nxënësve. Sipas institutit GAP i kushton komunës diku rreth 360.637 euro. Duhet të hartohet një plan i qartë, që gjatë 3-4 viteve të ardhshme, të mos zhvillohen konkurse të reja në arsim, pa nevojë, pa u menaxhuar fillimisht situata me gjithë mësimdhënësit që ekzistojn në sistem. Duhet shikuar organizimi i paraleleve, aty ku s'kanë nxënës. Kjo është pak e dhimbshme, por është e domosdoshme. Kemi raste këtë vit, kur një paralele me 3 nxënës, është transferuar mësuesi prej një shkolla në tjetër, edhe është dashur me hapur konkurs të ri, me marrë mësimdhënës të ri.

Ka pasur klasa me 25 nxënës, që drejtoria e arsimit I ka bërë dy paralele, prej një paralele me 25 nxënës, i keni bërë dy paralele me nga 12 nxënës. Kjo qasje nuk e zgjidh problemin, vetëm e thellon edhe e bën më të madh këtë problem. Centralizimi i arsimit, unë kam qenë drejtor në Klinë edhe komuna nuk ka punuar aq shumë në decentralizimin e shkollave. Kjo është shumë e nevojshme për funksionimin e shkollave ashtu siç duhet. Sa më e madhe autonomia e shkollave, sa më shumë përgjegjësi, sa më shumë kompetenca drejtoria e shkollave, aq më shumë përgjegjësi

komuna ka të drejtë me kërkuar atëherë. Kjo qasje centralizuese, ku një drejtor nuk mundet as sistemin e brendshëm të mësimdhënësve me e bërë, pa ndërhyrje, shpeshherë nga organet komunale, është qasje e gabuar edhe duhet të ndryshohet menjëherë. Siguria në shkolla është një problem tjetër. Se është e mundur që ju i keni ndriçuar gati të gjitha rrugët e fshatrave, e nuk jeni në gjendje me i ndriçuar mjediset e jashtme të disa shkollave, përfshirë gjimnazin. A e dini që në shkollat tona gjatë kësaj vere ka pasur thyrje, ka pasur vjedhje. Edhe pse organet e rendit janë duke u marrë me ato punë. Unë e pata ngritur një çështje, në seancën e janarit, kam ngrit çështja e problemit të qenve endacakë afër gjimnazit, sepse në të ardhmen dikush ka me pësuar. Drejtori më pati thënë se si të ngritën temperaturat se është shumë ftohtë, kemi me marrë masa.

Fatkeqësisht, është dashur me ndodhur një rast, një fëmijë domethënë me pësuar prej qenve endacakë, edhe sot nuk e di a ka marrë drejtoria e shërbimeve publike ndonjë masë me e rregulluar këtë problematikë, që raste të tilla mos me na ndodhur më.

Në vitin 2027 do të duhej të flisnim për pajisjen e shkollave tona me laboratore, me kabinete shkencore, me teknologji për kushtet moderne të mësimdhënies. Ne po flasim, a është në gjendje komuna me blerë dru dhe pelet për me ngrohur shkollat? Kjo është për keqardhje dhe është shumë shqetësuese. Nëse sot nuk investojmë në shkollat tona, nesër do të paguajmë çmim të madh, padyshim.

Në fund, i bëj thirrje drejtorisë së arsimit që të ndryshojë qasje pak, kështu miqësisht. Në vend që të merremi me kontrollimin e panevojshëmë të formaliteteve të tepërta, siç janë kontrolli i disa nënshkrimeve të mësimdhënësve në hyrje të shkollave, duhet të ulet dhe të hartojë një strategji për zhvillimin e arsimit në komunën e Klinës. Nëse vazhdojmë kështu, shkollat tona rrezikojnë të zbrazen. Ndërkaq ne do të vazhdojmë të bëjmë llogari politikë, secili prej veprimeve do të na sjellë dhe shumë vota.

Na jemi këtu për të bërë, më të mirën e mundshme për arsimin.

Znj Marqe Selmani Tanushi: Unë do të doja të falënderoj drejtorin i cili na dha një raport. Të gjithë e dimë që kemi probleme dhe këto nuk janë të reja, këto janë probleme të shumta. Mirëpo, ajo çka është më I madh është zvogëlimi i numrit të nxënësve, Zvogëlimi i numrit të nxënësve i bien të gjitha këto probleme, e kjo nuk është problem as i drejtorisë së arsimit, as i shkollës, as i komunës, është një problem i cili është mos me thënë global, se s'mundemi me ditë global, por është në gjithë Kosovën, është problem, sidomos në zonat rurale, sepse qytetet e kanë pak më të frekuentuar numrin e rritjes së popullsisë. Mirë kish me qenë që politikat, qasja, të jetë edhe më mirë sepse shkon në dobi të gjithëve.

z. Arben Limanaj: Ishim më mirë atëherë kur ishim më keq. Është një përkufizim shkurt, gjithë asaj çka mendoj për gjendjen aktuale në arsim E kam fjalën për periudhën e pasluftës, kur kishin filluar, s'ka ekzistuar as ligji për arsimin parauniversitar por mësimdhënës kanë filluar me ditarë. Jo që nuk punohet në arsim, sepse ka edhe puntorë të përkushtuar dhe përgjegjës shkollash, që e marrin seriozisht punën e tyre, në arsimimin e brezave. Shumë më mire është qëë procesi I mësimit në shkollë mos të filloi hiçse sa me filluar kështu gjysmak.

z. Qemajl Sejdiu, drejtor I DKA, shpjegoi që nuk është faji I shkollave për mungesë të ditarëve, për mungesë të numrit të nxënësve dhe për mungesë të strategjive kur ska mjete. Ai foli për shqetësimet që ne I kemi në arsim por që me to duhet të merret niveli qendror. Ndërsa në përgjgije ndaj z. Musliu për vizitat në shkolla të drejtorit , z. Sejdiu u përgjigj: " E sa i përket vizitave nëpër shkolla, keni qenë mësimdhënës edhe nuk është mirë me të dëgjuar qytetarë, që ne nuk mundemi me shku dhe me i pa apo shkojnë në orë, apo vijnë në orar të punës, apo fillojnë orën kur duhet, drejtoria është për atë punë, drejtoria e shkollës.Drejtoria e ka bërë, drejtoria e ka bërë me gjithë sekretarin që e kanë përgjegjësi.

Bashkëbisedimi I drejtorit Sejdiu dhe shefit te grupit kuvendar të PDK-së z. Musliu vazhdoi tutje rreth kësaj teme.

Pika 9 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe përgjigje

z. Esat Raci: Unë kam një kërkesë për kryetarin. E di, që nuk është në kompetencën tënde por rruga Sadik Rama, kam informacione që ajo rrugë ka nis me u shtruar por jo qysh duhet.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Po Esat, do të kujdesëm aq sa na lejon ligji dhe mundësitë

z. Ndrec Zefaj: Përshëndetje! Kam një pyetje për ekzekutivin, çka po ndodh me ndriçimin publik në rrugën Zllakuçan-Rranoc? Është vendosur që disa muaj, mirëpo nuk është lidhur ende dhe nuk është funksional

z. Naim Musliu: Një kërkesë e kam për drejtorinë e arsimit, konsideroj që fëmijët tanë shpeshherë kanë mungesë të informacionit rreth luftës së UÇK-së, luftëtarët e Kosovës, e shpeshherë edhe janë të keqinformuar. Prandaj, kërkesa ime është që në të gjitha shkollat e komunës së Klinës, në hyrjet e tyre, të vendoset flamuri me emblemën e UÇK-së, së paku derisa në përfundimin e procesit të padrejtë gjyqësor, faleminderit.

z. Qemajl Sejdiu, drejtor I DKA: Po pse jo? Ajo është krenaria jonë? Së pari është në zemrat e secilit prej nesh. Pse jo, është krenari?

z. Zenun Elezaj, kryetar: Do të përkujdesim për ndricimin që e përmendi Zefi, do të marrim masa.

z. Jeton Gashi: Përshëndetje kryesues, përshëndetje për të gjithë. Sipas disa ankesave, ndriçimi nëpër fshatra, shumica janë thyer e prishura. A lejohet që fshatarët të kujdesen vet apo duhet ta presim komunën?

z. Qendrim Millaku, drejtor I SHP: Janë lloj-lloj, lloj-lloj gjërash që vendosen nëpër siguresa për me mbet ndriçimi dit ndezur dhe natën mos me u ndezë, Është lajmëruar policia edhe në email zyrtar,

z. Arben Limanaj: Kemi pasur nja dy kërkesa që vijnë nga dy lagje të fshatit Caravik. njëra ka qenë për një objekt lagjeje, diçka për të pame dhe organizime të tjera. Edhe një kërkesë tjetër ka qenë nga lagja tjetër e Alikurtëve, që ka qenë për shtrirjen te varreza. Pranë i varrezave të tjera. Po

kërkoj prej ekzekutivit që të ndërhyjë për të gjetur një gjuhë të përbashkët mes dy lagjeve, dy familjeve të mëdha të fshatit tonë atje.

z. Enver Berisha, kryesues: Ashtu qysh jemi dakorduar bashkë me kryetarin kemi bërë hapa bukur shumë, duke i takuar të dy familjet, në një farë formë me e bërë një lloj mirëkuptimi në mes të familjeve, por realisht deri tani edhe përkundër shumë takimeve, me këto dy familje, nuk kemi mund me gjetë gjuhë të përbashkët dhe me i harmonizuar ata kërkesat e tyre. Ne si kuvend, edhe me kryetarin bashkë, i kemi shterur pothuajse të gjitha mundësitë, deri edhe Albert Bashotën që jeton në Itali, e kemi sjellur, dhe është takuar me familjet në fjalë dhe përkundër vullnetit shumë të mirë te Albertit, s'kemi mundur me gjetur marrëveshje.

Procesmbajtës:
Skënder Behramaj

Kryesues:
Enver Berisha